



iSIGURT.al
Qendra për Internet të Sigurt në Shqipëri
Safer Internet Centre in Albania



CRICA
Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri
Child Rights Centre Albania

alo **116 111**
TELEFONI I NDIHMËS PËR FËMIJËT



Support the Safer Internet Centre in Albania to protect children
from online sexual violence & exploitation.



Co-funded by
the European Union



SHENJAT E SHFRYTËZIMIT TË FËMIJËVE NË INTERNET QË ÇDO PRIND DUHET T'I NJOHË



SHENJA QË DUHET TË TË SHQETËSOJNË MENJËHERË:

Këto sjellje tek fëmijët mund të tregojnë kontakt të papërshtatshëm me dikë online:



- Fillon e mban sekrete në mënyrë të papritur ose fsheh ekranin e telefonit sa herë ju sheh ju në dhomë.
- Përdorim i celularit (ose pajisje të tjera të lidhura në internet) natën vonë me aplikacione që nuk i njihni.
- Merr mesazhe të shpeshta nga një numër i panjohur.
- Fshin historikun e bisedave ose të përdorimit të aplikacioneve.
- Përmend dikë dhe ju kërkon që t'a mbani sekret.

VINI RE NDRYSHIME NË SJELLJEN E FËMIJËS SUAJ?

Disa shenja dhe ndryshime në sjelljen e fëmijës suaj mund të tregojë se diçka nuk po shkon si duhet. Ja disa nga shenjat kryesore (por jo vetëm):



- Fillon të izolohehet nga familja ose miqtë.
- Zotëron dhurata ose para që nuk ia keni dhënë ju.
- Ka luhatje humori, frikë ose ankth.
- Përdor fjalë ose tregojnë njohuri seksuale të papërshtatshme me moshën.
- Ka rënie në mësimet ose humb interesin për hobet që ka patur zakonisht.



ÇFARË MUND TË BËSH SI PRIND OSE KUJDESTAR?

Nuk është e nevojshme të jeni ekspertë të teknologjisë – mjafton të jeni të pranishëm në jetën e fëmijës suaj.



Flisni herët dhe shpesh. Përdorni gjuhë të përshtatshme për moshën për të folur me fëmijët për sigurinë e tyre online.

Ja disa mesazhe kyçe që duhet t'ua përcillni fëmijëve:

- **Askush nuk duhet të të kërkojë kurrë foto.**
- **Mos mbaj sekrete që të bëjnë të ndihesh keq ose në siklet.**
- **Mund të vish gjithmonë tek unë. Do të kesh të gjithë mbështetjen tonë dhe çdo problem do t'a zgjidhim bashkë.**

ÇFARË MUND TË BËSH SI PRIND OSE KUJDESTAR?

Nuk është e nevojshme që të jeni ekspertë të teknologjisë – mjafton të jeni të pranishëm në jetën e fëmijës suaj. Flisni që herët dhe shpesh.



Përdorni gjuhë të përshtatshme për moshën për të folur për sigurinë e tyre online.

Ja disa mesazhe kyçe që duhet t'ua përcillni fëmijëve:

- Askush nuk duhet të të kërkojë kurrë foto.
- Mos mbaj sekrete që të bëjnë të ndihesh keq ose në siklet.
- Mund të vish gjithmonë tek unë. Do të kesh të gjithë mbështetjen tonë dhe çdo problem do t'a zgjidhim bashkë.

ÇFARË MUND TË BËSH SI PRIND OSE KUJDESTAR?

Përfshihuni në biseda pa çenuar privatësinë e fëmijës. Mbajini të gjitha pajisjet e fëmijës, që janë të lidhura me internetin, në mjedise të përbashkëta familjare. Përdorni aplikacione të kontrollit prindëror, kurdo është e mundur.



Gjatë bisedës bëni pyetje si psh.:

- Me kë bisedove sot?
- Çfarë të pëlqen më shumë të shohësh ose të luash online këto ditë?
- A ke ndonjë grup që ndjek online?

Vendosni rregulla digjitale bashkë me fëmijët – jo vetëm për ta.

ÇFARË MUND TË BËJ ISIGURT DHE ALO 116-111 PËR TY?




iSIGURT.al

Qendra për Internet të Sigurt në Shqipëri
Safer Internet Centre in Albania



alo 116111
LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI
Albanian National Child Helpline (ANCH)



- Mbylлим ose bllokojmë çdo profil apo faqe që dhunon fëmijët dhe adoleshentët në Shqipëri.
- Zhvillojmë sesione informimi për sigurinë digjitale për fëmijët, mësuesit, edukatorët dhe prindërit anembanë Shqipërisë.
- Trajnojмë mësuesit, profesionistët, institucionet, bashkitë, bizneset dhe OJF-të përmes programeve specifike.
- Avokojmë për ligje dhe politika më të forta për sigurinë online në nivel kombëtar, europian dhe global.



Mësoni më shumë dhe përfshihuni në përpjekjet tona për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve online. Na vizitoni tani:

www.iSIGURT.al

www.alo116.al

www.crca.al

